



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO		
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO		
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL		
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA		
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT		
Arhivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive		
No./Br.No.	2195	
Nr./Sq./Br. Str./No. pp.	3+3	
Data/Datum/Date:	13.06.2022	
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA		

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Department**

<b>Për:</b>	Ekrem Kastrati, Kryetari i Komunës së Malishevës Argjend Thaqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
<b>Kopje:</b>	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, MAPL Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Ardita Latifi, Zyrtare e Lartë për monitorim të Komunave	
<b>Përmes:</b>	Faton Peci, Ministër i MBPZHR-së Blerim Hasani, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZHR-së	
<b>Nga:</b>	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	Datë: 24.05.2022 Ref. 10.100/2022
<b>Zyrtarët përgjegjës:</b> 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Isah Rudaku, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR	
<b>Lënda:</b>	Përgjigje në Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Malishevës	
<b>Lloji i aktit:</b>	Rregullore Nr.02/221 për Përkrahjen e Fermerëve dhe Bizneseve në Sektorin e Bujqësisë në Komunën e Malishevës	

I/e nderuar Kryetar,  
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 11.05.2022, ka pranuar nga MAPL, Rregulloren Nr.02/221 për Përkrahjen e Fermerëve dhe Bizneseve në Sektorin e Bujqësisë të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, me datën 28.04.2022 si dhe i parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 05.05.2022.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të ligjshmërisë ashtu siç parashihej në nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në pajtim me Nenin 3 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, bënë:

## Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Rregullore Nr.02/221 për Përkrahjen e Fermerëve dhe Bizneseve në Sektorin e Bujqësisë të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, më datë: 28.04.2022.  
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.05.2022

Kërkesa për përkrahjen e fermerëve dhe bizneseve në sektorin e bujqësisë e propozuar me Rregulloren Nr.02/221 për Përkrahjen e Fermerëve dhe Bizneseve në Sektorin e Bujqësisë të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, më datë: 28.04.2022, është në pajtim me Nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2 pika (c), nenin 24 paragrafi 24.2 dhe nenit 40 (40.2) pika (a) të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28/04 Qershor 2008), *citohet*:

Neni 11 *“Kuvendi i komunës dhe kryetari kanë të drejtë të miratojnë akte dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre. Të gjitha aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës”.*

12.2. *“Aktet e kuvendit të komunës vlejnë në territorin e komunës që ka miratuar aktin. Këto akte përfshijnë: c) rregulloret komunale”;*

Neni 24 paragrafi 24.2 *“Buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake; granteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës; donacioneve dhe të hyrave të tjera”*

40.2 *“Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës”;*

Nenin 17 paragrafi 17.2, dhe nenin 38 paragrafi 1 Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare Nr.27/03.06.2008), *citohet*:

17.1 *“Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të pa rregullt paratë publike”.*

17.2 *“Shpenzimi i parave publike mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara dhe vetëm në përputhje me procesin i cili është themeluar nga Rregullat KMF sipas paragrafit 2 të nenit 38 të këtij ligji”.*

38.1 *“Nuk do të lejohen kurrfarë mjetesh nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për bërjen e pagesave kur nuk ekziston një njoftim aktual për alokimin e fondeve me anë të të cilit autorizohet përdorimi i të hollave për bërjen e pagesave të tilla”.*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

*“Interpretimi i dhënë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushë veprimtarinë legislative të Ministrisë përgjegjëse për bujqësi”.*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

*Me respekt,*



REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIQË E KOSOVËS-REPUBLIKA BOSNIA  
NUJENTI I KOMUNËS MALISHEVË  
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-GROPSKI OPSTINE MALISHEVO



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

05/05/2022  
02/221



KOMUNA E MALISHEVË

**RREGULLORE**  
**PER PËRKRAHJEN E FERMERËVE DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN E**  
**BUJQËSISË**

Malishevë, Prill 2022

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 2, pika "c", nenit 17, nenit 24 paragrafi 2, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (a), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 e datës. 4. qershor 2008"; neni 17, paragrafi 1 dhe 2, i Ligiit Nr. 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 27 e datës. 3 qershor 2018"; neni 36, paragrafi 3 i Rregullores Financiare Nr.01/2013 e datës 25 gusht 2013 të MF Shpenzimi i parave publike; neni 43, pika 4 dhe 6; Rregulloren e MF, Nr-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik, ftesës për njoftim publik nr.08/14 datë: 06.04.2022, në bazë të nenit 10, nenin 19 paragrafi 7 pika e, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur më date: 28.04.2022 miraton këtë:

## **RREGULLORE**

### **PER PËRKRAHJEN E FERMERËVE DHE BIZNESEVE NE SEKTORIN E BUJQËSISË**

#### **DISPOZITAT E PERGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Me këtë draft-rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndaj mjete financiare pa kthim nga kategoritë e subvencioneve dhe granteve për fushat e cekura në këtë draft-rregullore për personat fizik dhe juridik.
2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor për vitin aktual, DBPZHR bënë planin vjetor sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndanë mjete financiare buxhetore për realizimin e projekteve të planifikuara sipas procedurës së përcaktuar me këtë draft-rregullore.
3. Dispozitat e kësajë draft-rregullore zbatohen nga organet komunale gjatë përzgjedhjes së përfituesve.

##### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

1. Përveç përkufizimeve të përcaktuara me ligjet tjera përkatëse, përkufizimet e cekura më poshtë e kanë këtë kuptim:
  - 1.1 **Subvencionet dhe grantet** - përfshijnë të gjitha transferet e njëanshme, të pakthyeshme në formën e pajisjeve dhe makinave, serrave, material fidanor për pemë dhe perime, hardhi rrushi, bagëti, bletari, shpeztari, ndertim të stallave, farëra të llojeve të ndryshme e repromaterial tjetër për individ dhe biznese.
  - 1.2 **Përfituesit**-nënkupton Personat fizik dhe juridik që përfitojnë të mira materiale nga kategoria e subvencioneve apo granteve të planifikuara në buxhetin e komunës.

- 1.3 **Banor rezident**- nënkupton personin që jeton në Komunën e Malishevës dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.
- 1.4 **Komision**- nënkupton komisionin e emëruar nga kryetari i komunës, në koordinim me drejtorin e DBPZHR, për vlerësimin e aplikacioneve të parashtruara për subvencione dhe grante të ndryshme.

### **Neni 3**

#### **Procedurat e përgjithshme të përkrahjes me subvencione dhe grante**

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve dhe granteve nga Komuna e Malishevës mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike.
2. Gjatë përkrahjes përmes thirrjes publike të komunës përcaktohen qartë fushat e përkrahjes, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim.
3. Shqyrtimi i kërkesave mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas procedurave të parapara me nenin 6 të kësaj draft- rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave brenda thirrjes publike të Komunës bëhet brenda njëzetë (20) ditë pune nga dita e mbylljes së aplikimit.

### **Neni 4**

#### **Përgjashtimet nga përkrahja**

1. Personat jorezidentë në Komunën e Malishevës nuk mund të jenë përfitues nga Komuna e Malishevës.
2. Personi fizik dhe juridik brenda vitit mund të jetë vetëm njëherë përfitues i subvencionit apo grantit, përjashtimisht vetëm në rastet kur nuk ka aplikues të tjerë.
3. Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në kontratën në mes të Komunës së Malishevës dhe përfituesit, për 3 (tri) vitet e ardhshme përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e përfitimeve.

### **Neni 5**

#### **Shpallja publike për ndarjen e subvencioneve dhe granteve**

1. Procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve fillojnë përmes shpalljeve publike, të cilat publikohen në ueb-faqen e Komunës, rrjetet sociale, si dhe në tabelen për Publikime të komunës.
  - 1.1. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për të aplikuar për ndarjen e subvencioneve dhe granteve, të cilat përcaktohen sipas kësaj rregullore.

1.2. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 7 (shtat)ditë pune nga data e shpalljes.

1.3. Afati i një shpallje publike fillon që nga momenti kur publikohet në ueb-faqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve.

#### **Neni 6**

##### **Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas thirrjes publike**

1. Kryetari i komunës në koordinim me Drejtorin e DBPZHR-së, emëron komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, kurse në përbërje të këtijë komisioni duhet të ketë profesionistë që janë njohës të mirë të fushave specifike.
2. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve vepron në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe bazuar në thirrjen publike.
3. Kryesuesi i komisionit dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave duhet të jenë shërbyes civil, ndërsa njëri nga ta duhet të jetë nga sfera profesionale.
4. Përbërja e komisionit duhet të jetë prej 3-5 anëtarë.
5. Përbërja e komisionit duhet të bazohet mundesisht, mbi parimin e barazisë gjinore.
6. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kriterëve të paracaktuara.

#### **Neni 7**

##### **Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve**

1. Kryetari i komunës emëron komisione me mandat trevjeçar (3) për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve në përbërje të përfaqësuesve nga fusha specifike. Anëtarët e komisionit do të shërbejnë për një mandat.
2. Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve dhe granteve duhet të jenë shërbyes civilë dhe një anëtarë nga shoqëria civile.
3. Komisioni duhet të jetë në përbërje prej 3-5 anëtarëve.
4. Komisioni mbanë procesverbalin nga mbledhjet e tij, i cili duhet të nënshkruhet nga kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

#### **Neni 8**

##### **Parandalimi i konfliktit të interesit**

1. Në fillim të përzgjedhjes së përfituesve, komisioni duhet të siguroj që të mos ekzistoj konflikti i interesit i përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

2. Komuna si mbështetëse financiare duhet të siguroj shmangien e çfarë do konflikti të interesit në rastin e marrjes së vendimit për aplikacionet.
3. Anëtarët e komisionit vlerësues, përkatësisht të komisionit të ankesave, duhet paraprakisht të sigurohen që pjesëmarrja e tyre në këto komisione është në përputhje me legjislacionin në fuqi, për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë me të cilën deklarojnë se nuk ekziston konflikt interesi.
4. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtarët duhet të kërkojnë nga udhëheqësi zëvendësimin e tyre.
5. Anëtari rezervë i komisionit zëvendëson anëtarin i cili tërhiqet, përshkak të ekzistencës së konfliktit të interesit.

## **Neni 9**

### **Vlerësimi i aplikacioneve dhe vendimmarrja**

1. Komisioni pas vlerësimit të aplikacioneve në aspektin procedural vazhdon me shqyrtimin e aplikacioneve dhe atë jo më gjatë se njezetë (20) ditë pune, nga dita e përfundimit të afatit të aplikimit në shpalljen publike, varësisht prej projektit.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave veprojnë në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj draft-rregullore, sidhe legjislacionin në fuqi.
3. Rekomandimet e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve dhe granteve bëhet sipas kriterëve dhe poentimit.
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij, icili duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e komisionit.
5. Aplikacionet që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione dhe grante, do të refuzohen nga komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve.
6. Komisioni para bërjes publike të listës me përfitues të subvencionit apo grantit, listën e dërgon te Drejtori i DBPZHR-së për konsultim.
7. Komuna i njofton në mënyrë publike, në tabelën e shpalljeve për përfshirje ose jo në listën e përfituesve të subvencioneve apo granteve dhe njofton për të drejtën dhe procedurën e parashtrimit të ankesës.
8. Në këtë fazë komisioni vlerësues ka të drejtë të kërkoj sqarime shtesë nga aplikuesit.

## **Neni 10**

### **Përfundimi i vlerësimit dhe publikimi i rezultateve**

1. Pas përfundimit të vlerësimeve, rezultatet e vlerësimit publikohen në ueb-faqen e komunës dhe në tabelën e shpalljes publike.
2. Në afat kohor prej 7 ditëve palët e pakënaqura me shkrim i drejtohen komisionit vlerësues të ankesave.



3. Komisioni vlerësues i ankesave në afat prej 10 diteve bënë shqyrtimin e ankesave dhe japin konstatimin e tyre.

4. Në këtë fazë, komisioni vlersues kërkon nga aplikuesit e përzgjedhur në listen e rezultateve dhe listën e aplikuesve me dokumentacionin e tyre.

5. Në rast të dështimit të ndonjerit nga aplikuesit e listës preliminare të përfituesve për të përmbushur kerkesat e paragrafit 2 dhe 3 te këtij neni, do të merren në konsiderat aplikacionet që kanë mbetur jashtë listës paraprake dhe që kanë më së shumti pikë.

6. Rezultatet paraprake shëndrrohen në rezultate përfundimtare, nese brenda afatit të paraparë per ankesa nuk paraqitet ndonjë ankesë.

7. Nese është paraqitur ndonjë ankesë, rezultatet paraprake shëndrrohen në rezultate përfundimtare pasi të jenë trajtuar të gjitha ankesat e aplikuesve.

## Neni 11

### **Ruajtja e dokumentacionit**

1. Drejtoriae Bujqësisë, në të cilen ndahen subvencionet apo grantet, përgatitin raport, duke ofruar dokumentacion përkatës, ku përfshihen:

1.1. Lista e aplikuesve dhe dokumentet përcjellse, sipas kritereve të paraqitura në shpallje.

1.2. Dokumentet e komisionit perzgjedhës dhe kriteret e vlersimit.

1.3. Lista e aplikuesve per subvencione apo grante.

1.4. Lista e përfituesve me pikët e fituara.

1.5. Raportet dhe dokumentet tjera relevante protokollohen dhe një kopje e tyre dorzohet në arkivin e komunës.

## Neni 12

### **Kontrata në mes të Komunës së Malishevës dhe përfituesve të subvencioneve dhe granteve**

1. Për realizimin e perkrahjes duhet të lidhet një kontratë në mes të Komunës së Malishevës dhe përfituesit, me të cilin përcaktohen te drejtat dhe detyrat mes Komunes së Malishevës apo drejtorisë së Bujqësisë dhe perfituesit të subvencionit apo grantit, qellimin, formen e perkrahjes, shumen e mjeteve,afatet kohore, detyrat dhe përgjegjstitë e palëve, mbikqyrjen, raportimin, hyrjen në fuqi, sidhe pjesë tjera relevante rreth kontratës.

2. Kjo kontratë, përfituesve do t'u ofrohet për nënshkrim pasi ata ta bëjnë pagesen e participimit prej 30 % të vlerës së projektit.

## Neni 13

### **Ekzekutimi i vendimit**

1. Pas perfundimit të procesit të përzgjedhjes, Drejtori i DBPZHR-së në bashkëpunim me kryetarin e komunës marrin vendim për ndarjen e subvencioneve dhe granteve. Ky vendim bëhet i ekzekutueshëm nëse:

- 1.1 Nuk është paraqitur ankesë sipas nenit 7 të kësaj draft-rregullore;
- 1.2. Me vendimin e komisionit të ankesave refuzohet ankesa;
- 1.3. Komisioni i ka shqyrtuar ankesat dhe ka dhënë konstatimin përfundimtar.

#### **Neni 14**

##### **Monitorimi i përfituesve**

1. Për kontrata të sënjejtës natyrë, komuna apo drejtoria e Bujqësisë cakton një zyrtar përgjegjës, i cili duhet kujdeset për monitorimin dhe implementimin e projektit. Komuna mund të formoi edhe ekip për këtë qëllim.
2. Komuna ka të drejtë të inicioj auditimin e përfituesve për mënyrën e përdorimit të mjeteve të ndara nga komuna.
3. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejt dhe sipas vendimit apo kontratës për mjetet e ndara.
4. Monitorimi sipas paragrafit i mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite, nga data e përfitimit në lëmin e caktuar.
5. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës nga përfituesit, zyrtari/ekipi monitorues raporton në drejtorinë Bujqësisë, duke rekomanduar për hapat e mëtejshme. Masat e propozuara duhet të jenë procedurale me shkeljen e bërë nga përfituesi.
6. Në rastet e shkeljeve të rënda të kontratës- kryetari i komunës mund të nxjerrë vendim për anulimin e kontratës dhe mund të nis masa për iniciimin e procedurave gjyqësore përkatëse.

#### **Neni 15**

##### **Kriteret për raste urgjente-fatkeqësi elementare**

1. Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i mundshëm i subvencioneve dhe granteve për rastet urgjente, të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore janë si në vijim:
  - 1.1. Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme natyrore (Shërbimi Policor I Kosovës, komisioni i veçantë i komunës).
  - 1.2. Dëshmia se merret me veprimtarinë e caktuar bujqësore apo biznes të definuar.

#### **Neni 16**

##### **Përparësitë gjatë ndarjes të subvencioneve dhe granteve për zhvillim ekonomik- bujqësorë.**

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve apo granteve për zhvillim ekonomik dhe bujqësorë, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi specifike, si në vijim:

- 1.1. Bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;

1.2.Femrave, të rinjve, zonave rurale, personave fizik dhe juridik, kategorive të veqanta dhe komuniteteve;

1.3.Bizneset që kanë siguruar bashkfinancim nga palët e treta 40% te vlerës;

1.4.Bizneset që posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale bujqësore;

1.5.Bizneseve apo fermerve-personave fizik që nuk kanë përfituar në tri vitet e fundit nga Komuna, apo nga pushteti qendror apo nga ndonjë donator tjetër.

#### Neni 17

### Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe grante për persona fizik dhe juridik

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve dhe granteve, e të cilat ndikojnë në zhvillim ekonomik duhet të jenë (duke mos u kufizuar):

1.1.Projekti ideor i aplikuesit–Projektpropozimi (për Grante)

1.2.Dokumenti identifikues;

1.3.Certifikata e vendbanimit

1.4.Dëshmi për pagesën e taksave Komunale;

1.6.Dëshmi për bashkfinancim (nese ka bashkfinancim);

1.7.Numri identifikues të fermerit (NIF)për Grant;

1.8.Certifikatën e biznesit ( personat juridik)

1.9 Fletëposedimin për patundshmëri

1.10 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj komunës dhe ATK-së (personat juridik)

1.11 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

1.12 Deklarat se nuk është përfitues i ndonjë granti të Qeverisë apo komunal në këtë fushëveprimtari, brenda vitit fiskal.

#### Neni 18

### Përkrahja e fermerëve në bujqësi

1.Komuna me vendim të kryetarit përmes DBPZHR-sëmund të ndaj subvencione dhe grante për bujqësi, duke përfshir, por duke mos u kufizuar, për:

1.1. Zejet tradicionale

1.2. Fermerët;

1.3. Agrobizneset;

1.4. Teknologji informative bujqësore;

1.5. Aktivitetet e shoqatave, të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin Rural dhe turizmin;

1.6. Inkubatorët e biznesit;

1.7. Bizneset fillestare të bujqësisë;

1.8. Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillimin e biznesit;

1.9.Projekte të fermerve, shoqatave, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për komunën,

1.10.Organizimin e panairove, seminareve, vizitave studimore bashkfinancim;

1.11.Mbështetjen e projekteve të Vreshtarisë;

- 1.12. Projekteve në sektorin e pylltarisë;
- 1.13. Ndarjene paisjeve dhe mekanizmit bujqësor;
- 1.14. Ngritjen e serave;
- 1.15. Projekteve në fushën e pemëtarisë dhe perimtarisë;
- 1.16. Projekte në fushën e bletarisë;
- 1.17. Projekte në fushën e blegtorisë;
- 1.18. Projekte në fushën e lavërtarisë.
- 1.19. Përfitues të subvencioneve dhe granteve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunë të Malishevës.
- 1.20. Përfitues të subvencioneve dhe granteve për zhvillim ekonomik dhe bujqësor nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

2. Komuna publikon secilën thirrje për aplikim në ueb-faqenzyrtare të sajë dhe në tabelën e shpalljeve, dhe për secilën fushë të përkrahjes apo grantit bujqësor.

3. Komuna përmes drejtorisë së bujqësisë qdo fillimvit duhet ti njoftoj palët dhe veprimtarite interesuara përtë shpjeguar detajet e thirrjeve publike dhe përmes këtyre kritereve të aplikim.

## Neni 19

### Përparësitë gjatë ndarjes të subvencioneve dhe granteve për bujqësi

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve dhe granteve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna ju jep përparësi:

- 1.1. Zonave me prioritet të identifikuar nga komuna;
- 1.2. Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim, në përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe;
- 1.3. Fermerve me eksperiencë, të rinjve, personave me status të veçantë të cilët duan të merren me Bujqësi dhe Zhvillim rural;
- 1.4. Aplikuesve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë nuk kanë qenë përfitues nga ndonjë grant për bujqësi, të ndarë nga DBPZHR i komunës, pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër;
- 1.5. Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta, sipas vlerës jo më pak se 40% të vlerës së projektit.
- 1.6. Projektet që gjenerojnë vende të reja pune.

## Neni 20

### Transparenca në përkrahjen e fermerëve apo bizneseve

- 1. Komuna publikon listën e aplikuesve dhe dokumentet përcjellse sipas kritereve të paraqitura në shpallje.
- 2. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve brenda 4-7 ditë pune, pas vendimit për ndarje të subvencioneve apo granteve nga komisioni kompetent.
- 3. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbaj: emrin e përfituesit, sektorin, fshatin-vendbanimin prej nga vijnë përfituesit.

4. Publikimi i vendimeve dhe përfituesve nga ndarja e subvencioneve apo granteve bëhet në uebfaqen e komunës, në tabelen e shpalljeve.
5. Për secilin lloj të subvencionit bujqësor apo grante për biznese, drejtoria duhet të bëjë shpallje të veçantë publike dhe krahas kësaj duhet të vendos kriteret bazë për aplikim.
6. Komuna përmes drejtorisë së bujqësisë është e obliguar të ofroj informacione lidhur me procedurat e ndarjes së subvencioneve apo granteve dhe mënyrat e aplikimit për secilën palë të interesuar me kërkesë me shkrim.

### Kriteret e perzgjedhjes ne sektorin e Pemëtarisë

Nr.	Lloji I kriterit	Kriteri / kategoria	Poenat/piket
1	Kapaciteti ekzistues I fermes, sip. E cila dote ngritet, depo, mbrojtja kunder breshrit, sist. I ujit, Makineria, infrastruktura ne pemishte. etj	Drufrutor / Manor >2,5 ha / > 0.50 ha  >1ha-<3 /0.10-<0.5ha	55 pik  50 pik
2	Maredhanjet kontraktuale, kontratat me perpunusit e prodhimit,		10 pik
3	Mbrojtja e mjedisit dhe ndikimi klimatik.		10 pik
4	Vlera e investimeve te pranushme,	<10.000	10 pik
5	Pronsia e fermes	Toka ne emer te aplikusit	5 pik
6	Pergaditja profesinale	Diploma univertzitare/Bujqesi	5 pik
7	Gjinia e fermerit	fermer	2 pik
8	Perkrahja per her te par		3 pik
	<b>Gjithësejt:</b>		<b>100 pik</b>

### Kriteret e perzgjedhjes ne sektorin e Blegtoris/Qumshtit dhe Shpeztaris

Nr.	Lloji I kriterit	Kriteri / kategoria	Poenat/piket
1	Lloji I investimit ne ferm.	a)ndertim/zgjerim/ renovim te stalles apo pikes grumbulluse. b)Makineri, depo e plehut, depo e	35 pik

		sillazhit ose depo e sanes.	30 pik
2	Maredhanjet kontraktuale, kontratat me perpunusit prodhimit,	Kontr. Per dorzim per 1 vit per 50% te prodhimit.	10 pik
3	Mbrojtja e mjedisit dhe ndikimi klimatik.	Invest. Ne prodhimin e energjis se ripertritshme ne ferm	10 pik
4	Vlera e investimeve te pranushme,	<10.000 >10.00	10 pik 8 pik
5	Kapaciteti prodhues I fermes	Lop dele/dhi /Pula pika grumbulluse >10-30 100 krer/3000 mbi 20 fermer Me teper 30 mbi 300 nene 20 fermer	10 pik 5 pik
6	Menyra e mbajtjes kafshve	I lir I mbyllur	10 pik 5 pik
7	Pronsia e fermes	Toka ne emer te aplikusit	5 pik
8	Pergaditja profesinale	Diploma univerzitare/Bujqesi	3 pik
9	Gjinia e fermerit	femer	2 pik
10	Perkrahja per her te par		5 pik
	<b>Gjithësejt:</b>		<b>100 pik</b>

## Kriteret e perzgjedhjes ne sektorin e vreshtaris

Nr.	Lloji I kriterit	Kriteri / kategoria	Poenat/piket
1	Kapaciteti ekzistues I fermes, sip. E cila dote ngritet, depo, mbrojtja kunder breshrit, sist. I ujit, Makineria, infrastruktura ne vreshtë. etj	Vreshta >3 ha >1ha-<3 ha >0.3-.1 ha	60 pik 55 pik 50 pik
2	Maredhanjet kontraktuale, kontratat me perpunusit e	Kontr. Per dorzim te prodhimit me shume se	10 pik

	prodhimit,	50%	
3	Vlera e investimeve te pranushme,	<10.000	10 pik
4	Pronsia e fermes	Toka ne emer te aplikusit	5 pik
5	Pergaditja profesinale	Diploma univerzitare/Bujqesi	5 pik
6	Vend I investimit	Fshtrat kodrinore/ malore	5 pik
7	Perkrahja per her te par		5pik
	<b>Gjithësejt:</b>		<b>100 pik</b>

### **Kriteret e perzgjedhjes ne sektorin e Perimikulturave(Serra)- Patates**

Nr.	Lloji I kriterit	Kriteri / kategoria	Poenat/piket
1	Kapaciteti ekzistues I fermes, sip. E cila dote ngritet, ndertoht.	Serra / Patate  >25 ari / > 0.50 ha  >20 ari /0.10-<0.5ha	55 pik  50 pik
2	Maredhanjet kontraktuale, kontratat me perpunusit e prodhimit,	Kontrata per dorzimin e 50% te produktit	10 pik
3	Mbrojtja e mjedisit dhe ndikimi klimatik.	Invest. Ne prodhimin e energjis se ripertritshme	10 pik
4	Vlera e investimeve te pranushme,	<10.000  >10.000	10 pik
5	Pronsia e fermes	Toka ne emer te aplikusit	5 pik
6	Pergaditja profesinale	Diploma univerzitare/Bujqesi	5 pik
7	Gjinia e fermerit	femer	2 pik
8	Perkrahja per her te par		3 pik
	<b>Gjithësejt:</b>		<b>100 pik</b>

Neni 21

**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Komuna apo DBPZHR (Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural) lidhë kontratë me përfituesin apo përfituesit, në mënyrë që ç'do shkelje e kontratës, nga të dy palet të sanksionohet.
2. Përfituesi nuk mund ta shes, ta tjetërsoj, apo ta keqpërdor në çfarë do forme tjetër subvencionin apo grantin e përfituar.
3. Kryetari i komunës në dakordim me drejtorin e bujqësisë, vendos për themelimin e komisionit për përzgjedhjen e përfituesit ose përfituesve.
4. Komisionet e themeluara hartojnë formularët e veqanta të aplikimit për secilen fushë të përkrahjes.
5. Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës së Malishevës, si dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Malishevës.

## **Neni 22**

### **Ndryshimi dhe Plotësimi**

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, me propozimet e arsyetuara nga propozuesi.

## **Neni 23**

### **Zbatimi i Rregullores**

Për zbatimin e kësaj Rregullore kujdeset, Kryetari i Komunës përmes Drejtorive Komunale.

## **Neni 24**

### **Hyrja në fuqi**

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, kjo Rregullore hynë në fuqi, sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores ( QRK ) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren ( QRK ) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS**

